



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR KOMANDIMIN E 1 (NJË) PROKURORI
SI NDIHMËSMAGJISTRAT PRANË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME**

Me Vendimin Nr.336, dt. 27.10.2023, “Për plotësimin e 1 (një) pozicioni si Ndhmësmagjistrat pranë Prokurorisë së Përgjithshme përmes procedurës së komandimit të prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur të shpallë fillimin e procedurës për plotësimin e **1 (një) pozicioni si Ndhmësmagjistrat pranë Prokurorisë së Përgjithshme** përmes procedurës së komandimit.

Afati i komandimit do të jetë **5 (pesë) vjet**.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë fton të gjithë prokurorët të shprehin interesin për t'u komanduar nëse përmbushin kushtet e mëposhtme:

- a) Të jetë Prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- b) Të plotësojë kushtet ligjore për të qenë prokuror në nivel Apeli;
- c) Të mos shërbejë në një pozicion me mandat të kufizuar dhe nuk është i komanduar në një pozicion tjetër;
- d) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Kërkesa për shprehjen e interesit duhet të përmbajë këto dokumente:

- 1) Letër motivimi ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4);
- 2) CV e kandidatit, e përditësuar;
- 3) Çdo dokumentacion tjetër që vlerësohet nga kandidati si i nevojshëm.

Dokumentacioni që vërteton plotësimin e kritereve duhet të dorëzohet në adresën: **Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rr. “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”, Tiranë**, ose në formë elektronike në adresën e-mail karriera@klp.al brenda datës **13.11.2023, ora 24.00**.